



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Adresa: Rr. "Abdi Toptani", ish-hotel "Drini", Tiranë

Tel/Fax 04 22268141; 22268142

Nr. 127/6 Prot.

Tiranë, më 12.07.2017

V E N D I M

Nr.158, datë 12/07/2017

"Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit të Komisionerit. Nr. 36, datë 17.02.2017, "Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes, së administrimit të shërbimit civil në institucionin e Drejtorisë së Bujqësisë Elbasan, dhe paralajmërimit të institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë", në institucionin e Drejtorisë së Bujqësisë Elbasan"

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, si dhe Rregullores, "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit Nr. 36, datë 17.02.2017, "Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes, së administrimit të shërbimit civil në institucionin e Drejtorisë së Bujqësisë Elbasan, dhe paralajmërimit të institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë",

Vërej se:

Me Vendimin Nr.138, datë 30.12.2015, "Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në procesin e administrimit të shërbimit civil në Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe institucionet e varësisë që janë pjesë e shërbimit civil", Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka vendosur fillimin e procesit të mbikëqyrjes së përgjithshme në Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe institucionet e varësisë që janë pjesë e shërbimit civil. Bazuar në këtë vendim ka vijuar mbikëqyrja edhe në institucionin e Drejtorisë së Bujqësisë Elbasan. Ky proces është përmbysur me Vendimin Nr. 36, datë 17.02.2017, "Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes, në lidhje me zbatimin e ligjit në procesin e administrimit të shërbimit civil në institucionin e Drejtorisë së Bujqësisë Elbasan dhe paralajmërimit të institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë", të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në të cilin është vendosur:

1. Të miratoj raportin përfundimtar të mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me administrimin e shërbimit civil në Drejtorinë e Bujqësisë Elbasan, i cili është pjesë e këtij vendimi dhe të paralajmëroj institucionin për të rregulluar situatën e

paligjshmërisë në zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, duke kërkuar zbatimin e detyrave që do të specifikohen më poshtë.

2. Për të rregulluar situatën e paligjshmërisë në Drejtorinë e Bujqësisë Elbasan, njësia e burimeve njerëzore të institucionit dhe njësia përgjegjëse (DAP), në zbatim të nenit 111, 113, pika 1, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, në lidhje me punonjësit ***** dhe ***** , të cilëve i është deklaruar statusi i punësimit, pas largimit të tyre nga puna dhe ata nuk kanë treguar asnjë interes për statusin e përfutur të punësimit, duhet të veprojë si më poshtë:
 - Njësia e burimeve njerëzore e Drejtorisë së Bujqësisë Elbasan të njoftojë njësinë përgjegjëse (DAP), për ndërprerjen e marrëdhënies së punës dhe asaj financiare për punonjësit ***** dhe *****.
 - Njësia përgjegjëse (DAP) të anulojë aktin administrativ nr. 3325/39 prot., datë 31.10.2014, “Mbi deklarin e statusit të punësimit si nëpunës civil”, për punonjësin ***** , në pozicionin e punës, “Specialist në Sektorin e Veterinarisë”.
 - Njësia përgjegjëse (DAP) të anulojë aktin administrativ nr. 3325/33 prot., datë 31.10.2014, “Mbi deklarin e statusit të punësimit si nëpunës civil”, për punonjësin ***** , në pozicionin e punës, “Specialist në Sektorin e Veterinarisë”.
3. Për të rregulluar situatën e paligjshmërisë në Drejtorinë e Bujqësisë Elbasan, njësia përgjegjëse (DAP), në zbatim të nenit 67, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe nenit 111, 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, në lidhje me rastin e deklarin të statusit të punësimit në kundërshtim me ligjin, për shkak të mosplotësimit të kriterit të nivelit të diplomës, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit për nëpunësin civil, duhet të ndjekë hapat si më poshtë:
 - Të anulojë aktin administrativ nr. 2149/21, datë 15.08.2014, për deklarin e statusit të punësimit për punonjësin ***** , duke e ndryshuar pozicionimin e tij në raport me shërbimin civil, nga “nëpunës civil në periudhë prove”, në “punonjës në pritje të plotësimit të kriterit të nivelit të diplomës”, për arsye se, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, (data 26.02.2014), rezulton se ishte student në programin “Master Shkencor”.
 - Njësia e burimeve njerëzore të institucionit të mbikëqyrur duhet t’i kërkojë punonjësit ***** që të dorëzojë diplomën e përfundimit të programit të studimeve “Master i Shkencave” dhe listën e notave, pasi tashmë ka përfunduar afati i përcaktuar në ligj. Dokumentet duhet të jenë origjinale ose fotokopje të vërtetuara nga noteri.
 - Një kopje e dokumenteve, t’i dërgohet Departamentit të Administratës Publike, i cili duhet të vijojë me përfundimin e procedurës së deklarin të statusit të punësimit për këtë punonjës. Një kopje e dokumenteve të bëhet pjesë përbërëse e dosjes personale të këtij punonjësi.
4. Njësia përgjegjëse (DAP), a) në kushtet e ndryshimit që ka sjellë në regjimin juridik të marrëdhënies së punës, Vendimi nr. 877, datë 14.12.2016, i Këshillit të Ministrave,

*“Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 719, datë 31.10.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, për nëpunësit e Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural, i cili, i ka përfshirë ata përsëri në shërbimin civil, si dhe, b) duke marrë parasysh, detyrimin që ka DAP, për të zbatuar nenin 67, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, duhet t’i aplikojë këto ndryshime, sipas orientimeve në raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, edhe në rastin e punonjësve ***** , ***** dhe ***** , të cilët, për shkak të ristrukturimit, janë transferuar nga Drejtoria e Bujqësisë Elbasan në pozicionin e punës, “Specialist”, pranë Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural.*

- 5. Njësia përgjegjëse, Departamenti i Administratës Publike dhe njësia e burimeve njerëzore e institucionit të mbikëqyrur, duhet të marrin masa dhe të tregojnë kujdes, për të gjitha procedurat që kanë lidhje me administrimin e shërbimit civil, të cilat janë kryer në mënyrë elektronike e konkretisht, në këtë rast për formularët e përshkrimit të punës, t’i materializojnë ato edhe në formë shkresore, duke respektuar mënyrën dhe elementët që duhet të përmbajë kopja në letër e dokumentit elektronik, të përcaktuara në ligjin nr. 9880, datë 25.02.2008, “Për nënshkrimin elektronik”, i ndryshuar; ligjin nr. 10273, datë 29.04.2010, “Për dokumentin elektronik”, si dhe në udhëzimin nr. 1, datë 31.12.2012, të Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit, “Për vërtetimin e kopjes në letër të dokumentit elektronik nga institucionet publike”.*

Me qëllim kontrollin e zbatimit të ligjit në administrimin e shërbimit civil nga nëpunësit përgjegjës, në përputhje me hierarkinë administrative, ashtu dhe nga institucionet e ngarkuara nga ligji për mbikëqyrjen e shërbimit civil, këto kopje duhet të trajtohen në përputhje me kërkesat e ligjit për arkivat dhe normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë.

Në këtë këndvështrim, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore duhet të finalizojë procesin e hartimit të përshkrimeve të punës, duke u kujdesur që të merret mendimi i Departamentit të Administratës Publike dhe më tej t’i depozitojë ato në arkivin e institucionit, si dhe pranë Departamentit të Administratës Publike, ashtu si është arsyetuar në raport.

- 6. Njësia e burimeve njerëzore në Drejtorinë e Bujqësisë Elbasan dhe personat përgjegjës, të ngarkuar nga ligji me detyrën e vlerësimit të rezultateve në punë, duhet të mbajnë parasysh orientimet e Komisionerit, të cilat janë të materializuara në raportin e mbikëqyrjes, më qëllim kryerjen e vlerësimit të rezultateve në punë në mënyrë sa më objektive, duke e lidhur procesin me realizimin e detyrave konkrete të secilit nëpunës.*
- 7. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat 30 ditë nga marrja dijeni për këtë vendim. Institucioni i mbikëqyrur dhe njësia përgjegjëse, duhet të zbatojnë këtë vendim duke u bazuar në orientimet e dhëna në përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.*

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim verifikimin e zbatimit të detyrave të lëna në Vendimin paralajmëruar nr. 36, datë 17.02.2017, të Komisionerit, në institucionin e Drejtorisë së Bujqësisë Elbasan me vendimin nr. 145, datë 30.06.2017, “Për verifikimin e

zbatimit të vendimit të Komisionerit nr. 36, datë 17.02.2017 “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në Drejtorinë e Bujqësisë Elbasan dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”, ka vendosur fillimin e verifikimit të zbatimit të Vendimit nr. 36 datë 17.02.2017.

Për këtë qëllim u ngrit grupi i punës, me përbërje Stela Ndoka dhe Helga Peti, Specialistë në Drejtorinë e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, të cilët në datën 03.07.2017, u paraqitën pranë institucionit të Drejtorisë së Bujqësisë Elbasan.

Verifikimi u realizua nëpërmjet vizitës në institucionin e Drejtorisë së Bujqësisë Elbasan dhe subjekti u njoftua për fillimin e procesit me shkresën nr. 1343/2 prot., datë 30.06.2017 “Njoftim për fillimin e verifikimit”.

Grupi i punës, gjatë vizitës në subjekt komunikoi me njësinë e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe verifikoi materialet shkresore të cilat vërtetonin zbatimin e detyrave të lëna nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në vendimin paralajmëruar. Takimi me njësinë e burimeve njerëzore, si dhe verifikimi i akteve dhe dokumentacionit shoqëruar që administrohej nga kjo zyrë dhe zyra e Arkiv-Protokollit, është materializuar në procesverbalin e datës 03.07.2017, të mbajtur nga grupi i punës i Komisionerit dhe personi e kontaktit i institucionit, Drejtoria e Bujqësisë Elbasan, specialisti për burimet njerëzore.

Pasi u administruan dhe u trajtuan materialet shkresore, të vëna në dispozicion, rezultoi se:

- ✓ Në zbatim të nenit 111, 113, pika 1, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe pikës 2 të vendimit paralajmëruar të Komisionerit, njësia e burimeve njerëzore e Drejtorisë së Bujqësisë Elbasan, për të rregulluar situatën e paligjshmërisë, me shkresën nr. 174/1prot., datë 27.02.2017, “Kthim përgjigje”, ka njoftuar Departamentin e Administratës Publike, në lidhje me ndërprerjen e marrëdhënies së punës dhe asaj financiare për punonjësit ***** dhe *****. Ashtu sikundër është pasqyruar edhe në procesverbalin e mbajtur në subjekt gjatë procesit të verifikimit, rezulton se Departamenti i Administratës Publike nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për anulimin e akteve administrative të deklarimit të statusit për këta punonjës.
- ✓ Në lidhje me rastin e deklarimit të statusit të punësimit në kundërshtim me ligjin për punonjësin *****, për shkak të mosplotësimit të kriterit të nivelit të diplomës, përcaktuar në pikën 3 të Vendimit paralajmëruar, duke qenë se Drejtoria e Bujqësisë Elbasan është përfshirë për herë të parë në fushën e shërbimit civil, bazuar në vendimin nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, Njësia Përgjegjëse (DAP) duhej t’a kishte deklaruar këtë punonjës, si “punonjës në pritje të plotësimit të kriterit të nivelit të diplomës”. Gjatë procesit të verifikimit, rezultoi se njësia e burimeve njerëzore me shkresën nr. 269 prot., datë 24.03.2017, “Dërgojmë Vërtetimin e diplomimit” të punonjësit ***** ka dërguar pranë Departamentit të Administratës Publike diplomën e këtij punonjësi. Aktualisht, pritet reagimi i Njesisë Përgjegjëse, Departamentit të Administratës Publike për finalizimin e këtij procesi.
- ✓ Në lidhje me rekomandimin e Komisionerit në pikën 4 të Vendimit paralajmëruar, Njësia Përgjegjëse, Departamenti i Administratës Publike nuk është shprehur ende në

lidhje me aplikimin e ndryshimeve që ka sjellë në regjimin juridik të marrëdhënies së punës përfshirja e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural në shërbimin civil, në rastin e punonjësve ***** dhe ***** të cilët për shkak të ristrukturimit janë transferuar nga Drejtoria e Bujqësisë Elbasan pranë Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural.

Në këtë rast, duhet të mbahet parasysh nga njësia përgjegjëse fakti, që këta nëpunës, e gëzojnë statusin e nëpunësit civil që në momentin e deklarimit të tyre pranë Drejtorisë së Bujqësisë Elbasan. Ky fakt vlen për të përcaktuar kohëzgjatjen e punësimit të këtyre punonjësve në pozicionin e punës ku ata kryejnë detyrën, në momentin e deklarimit të statusit të punësimit pranë Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural.

- ✓ Në zbatim të pikës 5 të Vendimit paralajmërues njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit, në përputhje me ligjin nr. 9880, datë 25.2.2008, *“Për nënshkrimin elektronik”*, i ndryshuar, ligjin nr. 10273, datë 29.4.2010, *“Për dokumentin elektronik”* dhe udhëzimin nr. 1, datë 31.12.2012, të Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit, *“Për vërtetimin e kopjes në letër të dokumentit elektronik nga institucionet publike”*, me shkresën nr. 907 prot., datë 03.07.2017, *“Dërgohet Formulari i Përshkrimeve të Punës”*, ka dërguar për mendim formularët e përshkrimit të punës, pranë Departamentit të Administratës Publike. Aktualisht, pritet reagimi i Njesisë Përgjegjëse, Departamentit të Administratës Publike për finalizimin e këtij procesi.

Në lidhje me rekomandimin e Komisionerit për kryerjen e vlerësimit të rezultateve në punë në mënyrë sa më objektive, duke e lidhur procesin me realizimin e detyrave konkrete të secilit nëpunës, materializuar në pikën 6 të Vendimit paralajmërues, rezultoi se njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore në Drejtorinë e Bujqësisë Elbasan dhe personat përgjegjës të ngarkuar nga ligji me detyrën e vlerësimit të rezultateve në punë, e kishin përmbyllur procesin e vlerësimit të punës të 6 mujorit të parë të vitit 2017, duke mbajtur parasysh orientimet e Komisionerit në raportin përfundimtar të mbikëqyrjes.

Për sa u parashtrua më sipër, pas përfundimit të afatit për zbatimin e detyrave të lëna në Vendimin nr. 36, datë 17.02.2017, *“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në Institucionin e Drejtorisë së Bujqësisë Elbasan dhe paralajmërimit të institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”*, të Komisionerit, rezultoi se nga ana e njesisë së burimeve njerëzore të institucionit janë zbatuar të gjitha rekomandimet e lëna në vendimin paralajmërues. Aktualisht, pritet reagimi i Departamentit të Administratës Publike në lidhje me pikat 2, 3, 4 dhe 5 të vendimit të Komisionerit, e konkretisht:

1. Anulimin e akteve administrative të deklarimit të statusit të punësimit të punonjësve ***** dhe *****.
2. Deklarimin e statusit të punësimit për punonjësin ***** në kushtet e plotësimit të kriterit të nivelit të diplomës.
3. Aplikimin e ndryshimeve në regjimin juridik të marrëdhënies së punës për punonjësit e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, ***** dhe *****.
4. Konfirmimin nëse përshkrimet e punës janë hartuar në bazë dhe në përputhje me legjislacionin specifik të fushës apo formatin standard të miratuar.

Për këto arsye:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe Rregulloren “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e njësisë së burimeve njerëzore të institucionit të Drejtorisë së Bujqësisë Elbasan, duke zbatuar plotësisht rekomandimet e Vendimit nr. 36, datë 17.02.2017, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në Institucionin e Drejtorisë së Bujqësisë Elbasan dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”.
2. Verifikimin e mëtejshëm të pikave 2, 3, 4 dhe 5 të dispozitivit të Vendimit nr. 36, datë 17.02.2017, për të cilat kërkohet reagimi i Njesisë Përgjegjëse, Departamentit të Administratës Publike.
3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni i Drejtorisë së Bujqësisë Elbasan, Departamenti i Administratës Publike, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, si dhe të informohet Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në Kuvendin e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA